



25.11.2021

Njoftim për tatimpagues

Përditëso të dhënat në Sistemin EDI!

I nderuar tatimpagues,

Administrata Tatimore e Kosovës, ju njofton se evidentimi i llogarisë tuaj bankare në sistemin EDI nuk është e saktë, prandaj edhe nuk keni mundur të përfitoni nga subvencionet sipas Pakove të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, kërkojmë që sa më shpejt të bëni përditësimin e llogarisë bankare në Sistemin Elektronik EDI të ATK. Edhe nëse paraprakisht keni bërë përditësimin e të dhënave, kërkojmë që të përsëritni edhe njëherë pasi që është konstatuar nga Thesari se llogaria bankare që keni evidentuar në sistemin EDI nuk është e saktë dhe nuk është e mundur që t'ju rimbursohet ajo llogari për të përfituar subvencionet nga Qeveria.

Llogaria bankare që evidentoni në Sistemin EDI duhet të jetë në emër të biznesit.

Pra, nëse llogaria bankare e juaj përditësohet dhe vendoset e saktë, është e mundur që sa më shpejt nga Thesari të kreditohet llogaria e juaj.

Ju faleminderit për mirëkuptim!

ATK mban premtimin për kujdesin e vazhdueshëm ndaj tatimpaguesve!

Administrata Tatimore e Kosovës